

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Delushe Halimi dhe me procesmbajtësen Nazmije Beka, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Z.SH., nga P., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale, për shkak të anulimit të vendimit, lidhur me çështjen e pensionit me aftësi të kufizuar, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të paditëses e mungesë të të paditurit, më datë 14.07.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesëpadia e paditëses Z.SH., nga P.. **Anulohet** aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale, me nr. i dosjes 6007692 i dt.16.12.2013, dhe lënda i kthehet organit të paditur në rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata konform nenit 41 të LKA-së, shqyrtimin kryesorë e mbajti në prani të paditëses e mungesë të të paditurit, të ftuara me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Paditësja, në seancën e shqyrtimit të sotëm kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadisë, duke shtuar se edhe pse ka aplikuar disa here, e paditura i ka refuzuar këtë të drejtë, ashtu sikurse edhe me aktvendimin e dt. 16.12.2013, me të cilin e ka refuzuar ankesën e dt. 25.11.2013, të ushtruar kundër vendimit të komisionit mjeksor të shkallës së parë me të cilin i është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës së pensionit me aftësi të kufizuar. I propozon gjykatës që padia të aprovohet, vendimi kontestues të anulohet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

E autorizuar e të paditurës përmes përgjigjen në padi të datës 12.02.2016, ka theksuar se e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. I ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të bashkangjitura ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pabazuar duke lënë në fuqi vendimin kontestues.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, në shqyrtimin kryesorë të dt.14.07.2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi nr.6007692 i datës 16.12.2013, vendimi i dt. 16.10.2013, vlersimi i komisionit mjeksor i dt. 12.09.2013, shqyrtimi i ankesës i dt. 05.12.2013, si dhe bëhet shiqimi në dokumentacionin mjeksor të paditëses i cili gjendet si provë në shkresat e lëndës.

Gjykata vlerësoi vendimin e goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së, dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palës paditëse në padi dhe deklaratimet e saj në seancën e shqyrtimit kryesor, përgjegjen e të paditurës në padi si dhe pas

shqyrtimit të të gjithave dhe shkresave tjera të lëndës të kësaj çështje administrative konstatoi se: padia e paditëses është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljen thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84, par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e kontestuar, duhet patjetër të përmbajë, përveç tjerash, edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Neni 85 i ligjit të njëjtë parasheh se përveç rasteve kur ligji vet parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për rishqyrtim apo ankimet, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit (neni 86, par. 1 i të njëjtit ligj).

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetvetën dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se Këshilli i Ankesave me ekspert mjekësor të lëmive përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së paditëses Z.SH., nga Prishtina, të dt. 25.11.2013, në mënyrë të gjithanshme, në seancën e dt. 05.12.2013, i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë të dt.12.09.2013, në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit PPAK, ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit për persona me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme. Poashtu, në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se Komisioni ekspertëve mjekësorë nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore, ka vlerësuar komplet dokumentacionin mjekësorë, ku për bazë kanë marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësorë, si dhe raportet nga specialistet dhe është konstatuar se nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përbushur kriteret, për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme, siç përcaktohet me ligjin 2003/23, me ç'rast e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë.

Me vendimin e të paditurës të datës 16.10.2013, gjykata gjenë se paditëses i është refuzuar kërkesa për Pensionin e Përsoneve me Aftësi të Kufizuara, me konstatim se, arsye e refuzimit të kërkesës është "bazuar në vlerësimin e Komisionit mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtrueses të kërkesës, është ardhur në përfundim se të ju, aftësia e kufizuar e plotë dhe të përhershme nuk ekziston".

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk ka bërë fare arsyetim në aktvendimin e saj, se nga cila bazë paditëses i është refuzuar kërkesa për pensionin e personave me aftësi të kufizuar.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë, vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej 30 ditësh, në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i menjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 43, par.2 dhe nenit 46 par.3 të LKA-së,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr. 176/14 dt.14.07.2016

Procesmbajtësi,
Nazmije Beka

Gjyqtarja,
Delushe Halimi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.